



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Age Group shpk" të datës 19.04.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-25-1415-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik ""Age Group shpk" të datës 19.04.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-25-1415-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AGE Group" (tutje "parashtruesi") me datë 19.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-25-1415-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Vendimi për eliminimin është marrë mbi bazën e një devijimi të vogël në përmasat e një ulëseje të ofertuar, çka konsiderojmë se nuk përbën ndryshim material dhe është i justifikuar me dokumentacionin e paraqitur. Sipas katalogut dhe autorizimeve ulësja nga është sipas standardeve të FIFA dhe UEFA e e cila i plotëson të gjitha kriteret si materiale ashtu edhe fizike e kimike për përdorim në fusha sportive. Ndryshimi në 1 cm apo 2 cm nuk përbën ndonjë ndryshim material apo devijim i cili do të ishte në kundërshtim me Qëllimin e Aktivitetit të Prokurimit. Gjithashtu ne si OE se bashku me prodhuesin jemi të gatshëm të ofrojmë dimensionin sipas kërkesës së AK dhe se AK do të mund të kujdeset që gjatëzbatimit të projektit të trajtoj dhe realizoj kërkesat e veta".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Nuk keni ofruar dëshmi se keni plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale.

Ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit ne piken 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 4 është kërkuar qe:

Kërkesa:

4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun nga prodhuesi me specifikat e kërkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

Dëshmia:

4. Katalogun nga prodhuesi me specifikat e kërkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

Katalogun që ju keni dërguar në ofertën e tuaj nuk përmban kërkesat e kërkuara në specifikimin teknik të kërkuar nga AK. Në specifikimin teknik në pozicionin nr. 9 është kërkuar: Furnizimi dhe vendosja e ulëseve nga materiali pvc për tribunat e stadiumit me dimensione 45x43x33 cm, me katër renda. Ngjyra e ulëseve duhet të caktohet nga organi mbikëqyrës.

OE AGE group shpk në katalogun e tij ka ofruar katalogun me specifika që nuk i plotësojnë kërkesat e kërkuara në pozicionin nr. 9

Sa i përket pretendimeve ankimore është gjetur se parashtruesi nuk ka përmbushur specifikat teknike lidhur me pozicionin nr. 9. Ky fakt nuk është fare kontestues pasi që vet parashtruesi e konfirmon se nuk janë përmbushur ST mirëpo kërkon që AK të trajtoj këtë si devijim të vogël aritmetik. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë fare me gabime aritmetike por me një situatë ku dicka tjetër është kërkuar me ST dhe dicka tjetër është ofruar nga parashtruesi. Përmes nenit 59 par. 4 të LPP është përcaktuar si vijon: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Vlen të shtohet se edhe njësia kërkuuese që ka hartuar ST ka konfirmuar se parashtruesi nuk ka përmbushur kërkesat lidhur me poz. 9 të ST. Prandaj pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.04.2025

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.